

## KONCEPT

### Hakaton për të dhëna të hapura (30 nëntor - 3 dhjetor 2021)

#### Qëllimi kryesor i Hakatonit

Hakatonit për të dhëna të hapura është një sfidë 4-ditore në të cilën pjesëmarrësit duhet të krijojnë një zgjidhje kreative që do të mundësojë promovimin e konceptit të të dhënave të hapura. Qëllimi kryesor i Hakatonit është t'i sjellë të dhënat e hapura më afër qytetarëve dhe t'i prezantojë ato në një mënyrë të thjeshtë dhe inovative.

Produkti përfundimtar i Hakaton-it duhet të jetë një zgjidhje kreative për: vizualizimin e të dhënave nga bazat e të dhënave, lidhen e dy ose më shumë bazave të të dhënave ose lehtësimin e procesit të mbushjes dhe përditësimit të bazave të të dhënave publike, të publikuara nga një ose më shumë institucione publike. Ekipet mund të zgjedhin të zhvillojnë vetëm një nga konceptet e kërkuara ose të zhvillojnë një zgjidhje integrale që do të përfshijë dy ose tre elemente. Në bazë të kriterëve të përcaktuara do të zgjidhet vetëm një nga zgjidhjet e propozuara, ajo që do të renditet më e larta.

#### 1. Kush mund të paraqitet?

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë ekipet e përbëra nga studentë ose kompani "Start-up" (fillestare) në fushën e TI-së. Është e nevojshme që anëtarët e çdo ekipi të kenë njohuri nga programimi, dizajni, ekonomia, marketingu etj.

Fituesi i Hakatonit do të marrë mbështetje financiare në vlerë prej **3.000 dollarësh, të dedikuara për përfundimin e versionit demo në një aplikacion funksional.**

Bazat e të dhënave dhe regjistrat që janë në dispozicion janë në forma të ndryshme dhe kanë mënyra të ndryshme të publikimit. Organizatori i Hakatonit nuk ka asnjë detyrim t'i dorëzojë bazat e të dhënave në formë të përshtatshme për përpunim. Ekipet duhet t'i përpunojnë të dhënat në mënyrë të pavarur nëse nuk janë në formë të përshtatshme. Koncepti që do të zhvillohet gjatë Hakatonit nuk është e thënë t'i përmbajë të dhënat relevante, përkatësisht ai mund të bazohet në të dhëna të shpërndara në mënyrë të ngjashme që do të korrespondojnë me strukturën e bazës së të dhënave. Në rast se koncepti fitues bazohet në një bazë që nuk është e përshtatshme për përpunim, ajo do të sigurohet në mënyrë shtesë nga institucioni përkatës, për ta zbatuar me sukses konceptin fitue.

## 2. Rregullat e Hakatonit

- Në Hakaton marrin pjesë maksimum 10 ekipe;
- Një ekip mund të jetë i përbërë nga paktën tre anëtarë, e më së shumti tetë;
- Një kompani (kompani “Start-up” - fillestare) mund të paraqesë vetëm një ekip;
- Ekipet punojnë sipas zgjedhjes së tyre, në mënyrë virtuale ose me prezencë fizike në ambientet e “Start-up”-it ose në ambiente të tjera;
- Ekipet gjatë Hakatonit do të marrin këshilla dhe mbështetje nga mentorët dhe organizatorët;
- Takimet me mentorët e Hakatonit do të organizohen dhe do të zhvillohen përmes mjeteve online;
- Terminet për mentorim përcaktohen nga ana e mentorëve, kurse pjesëmarrësit zgjedhin një ose më shumë termine, sipas orarit dhe preferencave të tyre;
- Zhvillimi i kodit përpara ngjarjes me qëllimin e vetëm të përdorimit të kodit gjatë ngjarjes është në kundërshtim e rregullave dhe nuk lejohet;
- Ekipet duhet ta ndërpresimin programimin (kodimin) sapo të shënohet fundi i Hakatonit (3 dhjetor në ora 11:00) dhe prezantimi i produktit demo së bashku me një link që çon te produkti dërgohet në adresën e e-mail-it [hakaton@metamorphosis.org.mk](mailto:hakaton@metamorphosis.org.mk);
- Produkti demo duhet të zhvillohet gjatë kohëzgjatjes së Hakatonit;
- Produkti demo duhet të zhvillohet në gjuhën maqedonase.

## 3. Regjistrimi i pjesëmarrësve

Regjistrimi i pjesëmarrësve bëhet duke e plotësuar [formularin](#) në vijim. Të gjithë anëtarët e ekipit duhet të regjistrohen individualisht.

## 4. Koncepti për lidhjen, prezantimin ose vizualizimin e bazave të të dhënave të publikuara nga institucionet publike

### Çfarë kërkohet?

Duhet të zhvillohet një aplikacion për ueb/celular që do të mundësojë vizualizimin, shfaqjen interaktive dhe/ose lehtësimin/digjitalizimin e proceseve për mbushjen dhe përditësimin e të dhënave nga bazat e të dhënave të publikuara nga organet e administratës shtetërore. Lejohet bashkimi, kombinimi dhe lidhja e dy ose më shumë grupeve të ngjashme të të dhënave.

Duhet të zhvillohet një aplikacion për ueb/celular që do të mundësojë shfaqjen e vazhdueshme të bazave të të dhënave që publikohen rregullisht nga organet e administratës shtetërore. Në 4 vitet e fundit, Qeveria ka publikuar një sërë mjetesh dhe bazash të të dhënave që janë vënë në dispozicion të publikut. Aktualisht ekzistojnë mundësi të shumta për të përdorur të dhënat dhe për të krijuar baza të dhënash të reja ose produkte që do të përdoren për t'i shfrytëzuar sa më mirë të dhënat që janë në dispozicion publik. Në të njëjtën kohë, shumë baza të të dhënave publikohen si

të dhëna të papërpunuara dhe publiku nuk sheh asnjë vlerë të shtuar nga publikimi i tyre. Qëllimi kryesor i aplikacionit duhet të jetë shfaqja e të dhënave që publikohen sot në formë tabelare dhe pa informacion shtesë. Në të njëjtën kohë, ka të dhëna që janë të ngjashme dhe duke i kombinuar ato mund të jepet informacion shtesë që do të jetë në dobi dhe në interes të qytetarëve.

Ekipet janë të lira të zgjedhin dhe kombinojnë grupe të dhënash nga ato që janë ofruar më poshtë ose të përpunojnë të dhëna sipas zgjedhjes së tyre. Përfshirja e elementeve të lojërave ose ndërveprimi gjatë shfaqjes së të dhënave do të konsiderohet përparësi gjatë zgjedhjes së zgjidhjes më të mirë.

Për më tepër, ekipet që do të mundësojnë dhe ofrojnë zgjidhje inovative për mbushjen, mbledhjen dhe përpunimin më të thjeshtë të të dhënave (që do të lehtësojë ose digjitalizojë praktikën aktuale), do të kenë përparësi gjatë zgjedhjes së zgjidhjes më të mirë. Prandaj, zgjidhja duhet njëkohësisht duhet të ketë dizajn të kuptueshëm dhe një «back-end» të thjeshtë, si p.sh. *Përdoruesi duhet të jetë në gjendje të ketë qasje në të dhënat në mënyrë të thjeshtë, të jetë në gjendje të bëjë kërkime, krahasime ose llogaritje të ndryshme, ndërsa institucioni duhet të jetë në gjendje t'i futë dhe t'i përditësojë të dhënat në format tabelor në mënyrë të thjeshtë ose të automatizuar, kurse sistemi t'i lexojë, përpunojë dhe t'i shfaq ato në mënyrë të pavarur.*

Në fund, konceptet që do të demonstrojnë potencial për komercializim ose për përdorimin e të dhënave që janë të disponueshme publikisht për të zgjidhur një problem të caktuar ose për të përmbushur një kërkesë të tregut do të kenë përparësi gjatë zgjedhjes së zgjidhjes më të mirë.

Nëse ekipi që merr pjesë në Hakaton ka një bazë të dhënash private që dëshiron ta kombinojë me grupe të dhënash publike, do të konsiderohet si përparësi gjatë zgjedhjes së zgjidhjes më të mirë.

## 5. Kriteret e vlerësimit

Çdo projekt demo gjatë prezantimit (pitching) online të zgjidhjeve demo për aplikacionin përpara Komisionit për përzgjedhjen e zgjidhjes fituese vlerësohet individualisht nga secili anëtar i Komisionit, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit:

### a. Inovacioni i idesë/zgjidhjes - 10%

Me këtë kriter vlerësohet shkalla e origjinalitetit të idesë. Është e nevojshme që ideja të jetë ndryshe nga ajo që ekziston aktualisht ose të ofrohet diçka e re që nuk ekziston fare në Maqedoninë e Veriut. Inovacion konsiderohet gjithashtu edhe një përmirësim drastik i një zgjidhjeje që ekziston aktualisht, por që ka mangësi.

### b. Harmonizimi me qëllimet e Hakatonit - 20%

Me këtë kriter vlerësohet niveli i përmbushjes së kriterëve të Hakatonit. Ideja duhet t'i respektojë udhëzimet për promovimin, afrimin dhe thjeshtimin e proceseve dhe mekanizmave të të dhënave të hapura.

### c. Shkalla e integritit - 15%

Me këtë kriter vlerësohen karakteristikat teknike të konceptit, gjegjësisht sa i thjeshtë është për punë, a ka zgjidhje për mënyrën e përditësimit të vazhdueshëm, a ka një burim të dhënash të përcaktuar qartë dhe mundësi për lidhje me bazat ekzistuese të të dhënave. Nëse të dhënat janë në një format që është i papërshtatshëm për përpunim, atëherë koncepti duhet të ofrojë një mënyrë që të dhënat përkatëse të ofrohen në mënyrë të vazhdueshme në një format të përshtatshëm.

#### d. Realizueshmëria e zgjidhjes ideore - 20%

Me këtë kriter vlerësohet niveli i realizueshmërisë së zgjidhjes së ofruar. Ekipet që kanë një ide të qartë se si të realizojnë konceptin duhet të kenë përparësi gjatë vlerësimit të këtij kriteri.

#### e. Prezantimi - 10%

Me këtë kriter vlerësohet cilësia e prezantimit, respektimi i kohës për prezantim, përgatitja e ekipit, koordinimi i tyre dhe përgjigja e qartë ndaj pyetjeve të parashtruara nga anëtarët e jurisë.

#### f. Kapaciteti i ekipit - 20%

Me këtë kriter vlerësohet gatishmëria e ekipit për ta realizuar konceptin pas përfundimit të Hakatonit. Ekipi duhet të përbëhet nga anëtarë me aftësi dhe sfonde të ndryshme profesionale që janë komplementare dhe kyçe për realizimin e suksesshëm të idesë.

#### g. Përfshirja e mjeteve për grupet e marginalizuara - 5%

Me këtë kriter vlerësohet nëse zgjidhja përmban mjete që janë të dedikuara për grupet e marginalizuara, gjegjësisht a u ofrojnë atyre një qasje më të thjeshtë në platformë.

### **Numri i përgjithshëm i pikëve: 100**

**Shkalla e vlerësimit:** prej 1 deri në 5 (ku 1 është nota më e ulët dhe 5 është nota më e lartë)

Fituesi i Hakaton është ekipi/zgjidhja demo që ka marrë/fituar më shumë pikë. Në rast të numrit të barabartë të pikëve midis dy ose më shumë ekipeve, vota e bartësve të projektit është vendimtare.

## **6. Pyetje dhe përgjigje**

Pyetjet tuaja në lidhje me hakatonin mund t'i dërgoni në [hakaton@metamorphosis.org.mk](mailto:hakaton@metamorphosis.org.mk); më së voni deri më 20 nëntor 2021.

## **7. Shembuj, regjistra dhe baza të të dhënave të propozuara**

Shembuj të portaleve nga vende të tjera:

- a. World Health Organization (WHO) - Global Health Observatory data [https://www.who.int/gho/maternal\\_health/reproductive\\_health/adolescent\\_fertility/en/](https://www.who.int/gho/maternal_health/reproductive_health/adolescent_fertility/en/)
- b. Qeveria e Singaporit - Të dhënat demografik [https://data.gov.sg/dataset/resident-population-by-ethnicity-gender-and-age-group?resource\\_id=f9dbfc75-a2dc-42af-9f50-425e4107ae84](https://data.gov.sg/dataset/resident-population-by-ethnicity-gender-and-age-group?resource_id=f9dbfc75-a2dc-42af-9f50-425e4107ae84)
- c. Transparency International <https://www.transparency.org/gcb2013/country?country=afghanistan>
- d. Gjeorgjia - <https://budgetmonitor.ge/en>
- e. 40 projekte të të dhënave të hapura - <https://carto.com/blog/forty-brilliant-open-data-projects-preparing-smart-cities-2018/>

## Proposed registers:

- [www.data.gov.mk/organization/mnhnctepctbo-3a-o6pa3obahne-n-hayka](http://www.data.gov.mk/organization/mnhnctepctbo-3a-o6pa3obahne-n-hayka) - regjistri i të gjitha shkollave fillore në territorin e RMV-së. Ky regjistër mund të kombinohet me regjistra të tjerë që janë në dispozicion të publikut.

### - *Financat*

\* [www.finance.gov.mk/mk/igri](http://www.finance.gov.mk/mk/igri) - nuk ka regjistër të licencave të lëshuara për lojërat e fatit, por pas publikimit të licencave të lëshuara, lehtësisht mund të bëhet

\* një regjistër që mund të shfaqet në kombinim me regjistra të tjerë.

\* <http://nbstat.nbrm.mk/pxweb/mk/> - Baza e të dhënave të BPRMV-së, e cila i përmban të gjitha të dhënat e prodhuara nga Banka Popullore, por edhe të dhëna që nuk janë të dhëna të Bankës, por që kanë të bëjnë me politikën monetare.

### - *Shëndetësia*

\* [www.data.gov.mk/organization/3dpabctbo](http://www.data.gov.mk/organization/3dpabctbo) - regjistrat në portalin e të dhënave të hapura

\* [http://zdravstvo.gov.mk/sekundarna\\_i\\_tercierna/](http://zdravstvo.gov.mk/sekundarna_i_tercierna/) - regjistra të institucioneve shëndetësore në RMV

\* <https://lekovi.zdravstvo.gov.mk/> - regjistrat që lidhen me barnat, barnatoret (farmacitë) dhe pajisjet ndihmëse mjekësore

### - *Mjedisi jetësor*

\* [http://www.moepp.gov.mk/?page\\_id=2699](http://www.moepp.gov.mk/?page_id=2699) - regjistra që mirëmbahen nga Ministria

\* <http://data.gov.mk/organization/mxctttt> - regjistra shtesë, të publikuar në portalin e të dhënave të hapura

### - *Bujqësia, Pylltaria dhe Ekonomia e Ujërave*

\* <http://data.gov.mk/organization/mnhnctepctbo-3a-3emjodejictbo> – regjistrat e publikuar në portalin e të dhënave të hapura

\* <http://www.mzsv.gov.mk/> - regjistra shtesë të publikuar në ueb-faqen e Ministrisë (duhet të shkoni te Regjistrat Aktivë në MBPEU)

### - *Ekonomia*

\* <http://data.gov.mk/organization/ekohomnja> – regjistrat në portalin e të dhënave të hapura

\* <https://economy.gov.mk/docs/registri> – regjistrat e publikuar në ueb-faqen e Ministrisë

## Bazat e sugjeruara të të dhënave:

- [www.open.finance.gov.mk](http://www.open.finance.gov.mk) - Bazë e të dhënave në të cilën mund të shihen të gjitha transaksionet që janë kryer dhe kaluar përmes Thesarit të Ministrisë së Financave. Baza e të dhënave përditësohet çdo 2 javë dhe përmban të dhëna të papërpunuara që mund të përpunohen për qëllime hulumtuese.

- [www.finance.gov.mk/mk/node/575](http://www.finance.gov.mk/mk/node/575) - Grupe të dhënash në lidhje me Buxhetin e RMV-së. Disa nga të dhënat janë në formatin XML i cili mundëson përpunimin e tyre të mëtejshëm. Të dhënat e buxhetit janë përmbledhur në ueb-faqen [www.budget.finance.gov.mk](http://www.budget.finance.gov.mk), - ueb-aplikacion për Buxhetin qytetar. Të dhënat për buxhetin janë të dobishme gjatë analizimit të politikave publike dhe të fondeve që janë paraparë për realizimin e tyre në vitet aktuale dhe të kaluara.
- [www.finance.gov.mk/mk/node/898](http://www.finance.gov.mk/mk/node/898) - Grupe të dhënash në lidhje me ekzekutimin e buxheteve të pushtetit qendror dhe lokal. Këto të dhëna mund të përdoren për ndërlidhje me bazat e të dhënave të institucioneve dhe njësisive të tjera të vetëqeverisjes lokale.
- [www.e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/Home.aspx#/home](http://www.e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/Home.aspx#/home) - Ueb-aplikacion që ofron një pasqyrë të plotë të furnizimeve publike të kaluara, të tashme dhe të ardhshme në të gjitha institucionet shtetërore. Baza e të dhënave nuk ka të dhëna të hapura dhe të gjitha hulumtimet duhet të bëhen në mënyrë të pavarur ose duke siguruar qasje në informatat me karakter publik [www.opendata.mk/Home/Tekstualni?Category=2](http://www.opendata.mk/Home/Tekstualni?Category=2) - Portal që i përpunon të dhënat në lidhje me furnizimet publike (baza e jashtme të të dhënave).
- [www.air.moepp.gov.mk](http://www.air.moepp.gov.mk) - Baza e të dhënave për stacionet matëse të cilësisë së ajrit të vendosura nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.
- [www.data.gov.mk/organization/mbp](http://www.data.gov.mk/organization/mbp) - data.gov.mk i është një portal që i përmban të gjitha të dhënat e hapura të institucioneve shtetërore, por më i saktë është kërkimi sipas organizatave. Ky link është i dedikuar për të dhënat e MPB-së. Më shpesh, grupet e të dhënave grumbullohen dhe kanë të bëjnë me sigurinë publike dhe sigurinë e trafikut.

#### Baza e të dhënave të propozuara nga shoqëria civile:

- [www.opendata.mk](http://www.opendata.mk) - Baza e të dhënave e Qendrës për Komunikime Civile ka shumë të dhëna lidhur me financat publike. Shumica e të dhënave përpunohen nga Qendra.
- [www.mojvozduh.eu](http://www.mojvozduh.eu) - Baza e të dhënave Ajri im përbëhet nga të dhëna që lidhen me cilësinë e ajrit. Në kuadër të aplikacionit ka edhe baza të të dhënave (<https://github.com/jovanovski/MojVozduhExports>) të cilat janë të lehta për t'u përpunuar dhe kanë vizualizim të një pjese të të dhënave (<https://mojvozduh.eu/projects/crowdsourcing>)